



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 244/6 Prot.

Tiranë, më 05.05.2016

**V E N D I M**  
**Nr. 50, datë 05.05.2016**

*“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit,  
filluar me Urdhrin nr. 244/1 prot., datë 16.03.2016”*

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenet 14 e 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në përfundim të procedurës së inspektimit,

**VËREJ SE :**

Në zbatim të Urdhrit të verifikimit nr. 244/1 prot., datë 16.03.2016, pas marrjes në shqyrtim të një informacioni, të regjistruar me nr. 244/5 prot., datë 11.04.2016, u krye hetimi administrativ për verifikimin e procedurës së ndjekur nga institucioni, në lidhje me transferimin e përhershëm për shkak ristrukturimi, të nëpunësit civil \*\*\*\*\* nga pozicioni “Specialist për promovimin e turizmit”, pranë Bashkisë Pogradec, në pozicionin “Punonjës (ndihmës administrativ) për zhvillimin e bujqësisë”, në Njesisë Administrative Trebinjë, të Bashkisë Pogradec.

Nga aktet e administruara ka rezultuar se, Nëpunësi \*\*\*\*\*, është pranuar në shërbim civil, rregullisht, pas kryerjes së procedurës të konkurrimit, sipas kërkesave të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” që ishte në fuqi në atë kohë. Ai ka filluar periudhën e provës me aktin nr. 58, datë 08.06.2005, të Kryetarit të Bashkisë Pogradec, “Për emërim kuadri”, në pozicionin “Specialist i nivelit të lartë për informimin”, në Drejtorinë e Shërbimeve

dhe Burimeve Njerëzore të kësaj bashkie, të cilën pasi e ka përfunduar me sukses, me aktin nr.25, datë 08.06.2006, të Kryetarit, është konfirmuar nëpunës civil.

Gjatë periudhës që ka vazhduar punën në këtë institucion, është transferuar dy herë në detyrë, duke ruajtur nivelin “*specialist*”. Konkretisht, me aktin nr. 20, datë 01.04.2007, të Kryetarit të Bashkisë Pogradec, është transferuar nga pozicioni “*Specialist i nivelit të lartë për informimin*”, në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, në pozicionin “*Specialist i nivelit të lartë për koordinimin me organizatat dhe shoqatat*”, në Drejtorinë e Turizmit. Për shkak të ristrukturimit të institucionit, me aktin nr. 77, datë 12.10.2011, është transferuar, në pozicionin “*Specialist i nivelit të lartë për promovimin e turizmit*”, në Sektorin e Promocionit të Turizmit, në Drejtorinë e Ekonomisë dhe Turizmit, të kësaj Bashkie.

Fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, e ka gjetur këtë punonjës në pozicionin “*Specialist i nivelit të lartë për promovimin e turizmit*”, në Sektorin e Promocionit të Turizmit, në Drejtorinë e Ekonomisë dhe Turizmit. Për këtë arsye, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, në kushtet kur kishte më shumë se një vit në të njëjtin pozicion pune, në mbështetje të nenit 67, të ligjit dhe Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, me aktin nr. 9, datë 13.06.2014, ka deklaruar me të drejtë statusin e punësit, të nëpunësit civil në këtë pozicion.*

Më tej, rezulton se, Këshilli i Bashkisë Pogradec, me aktin administrativ nr. 32, datë 29.09.2015, “*Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Pogradec, Institucioneve në vartësi dhe Njësive Administrative*”, ka përcaktuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Pogradec dhe Njësive Administrative në varësinë e saj. Në zbatim të këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë Pogradec, ka nxjerrë Urdhrin nr. 98, datë 28.10.2015, për miratimin dhe implementimin e strukturës dhe organigramës së bashkisë.

Nga krahasimi i strukturës së mëparshme të Bashkisë Pogradec, me strukturën aktuale të saj, konstatohet se nuk ka shkurtim të pozicioneve të punës (nga 112 punonjës që ishin më parë janë bërë 150 punonjës), por ka ristrukturim të tyre, që konsiston në riorganizimin, konceptimin e ri të pozicioneve të punës, shkrirjen/bashkimin apo ndarjen e tyre, etj.

Duke e analizuar konkretisht rastin e punonjësit \*\*\*\*\* , konstatohet që, “*Drejtoria e Ekonomisë dhe Turizmit*” (ku ai punonte më parë), siç parashikonte struktura e vjetër, për shkak të ristrukturimit të institucionit është shkrirë dhe janë krijuar dy drejtori të reja “*Drejtoria e Projekteve Komunitare dhe Zhvillimit të Turizmit*” dhe “*Drejtoria e Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare*”, duke u shoqëruar kjo edhe me ndryshimin e kriterëve dhe kërkesave të veçanta për pozicionet përkatëse të punës.

Në përshkrimin e ri të pozicionit “*Specialist i nivelit të lartë për promovimin*”, (ku punonte \*\*\*\*\* më parë), i cili aktualisht është pranë “*Drejtorisë së Projekteve Komunitare dhe Zhvillimit të Turizmit*”, në rubrikën “*Kërkesa të Veçanta*” kërkohet që nëpunësi të zotërojë të paktën diplomë të nivelit “*Bachelor*” në shkencat ekonomike ose të njehsuar me të, ndërkohë

që nëpunësi \*\*\*\*\* është diplomuar në Fakultetin e Bujqësisë, Dega Ing. Agronomike (ka fituar titullin Ing. Agronom).

Për shkak të rikonceptimit që ka pësuar struktura e “Drejtorisë së Ekonomisë dhe Turizmit” dhe mospërputhjes ndërmjet kërkesave specifike të pozicionit të punës që kishte nëpunësi \*\*\*\*\* me profilin e tij arsimor, Komisioni i Ristrukturimit, i krijuar me aktin nr. 394, datë 30.12.2015, ka shqyrtuar mundësinë e transferimit të tij në një pozicion tjetër, të të njëjtës kategori, siç kërkon pika 1, e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Nisur nga ky propozim, njësia përgjegjëse me aktin nr. 26, datë 21.01.2016, ka vendosur të transferojë në mënyrë të përhershme këtë nëpunës, në pozicionin “Punonjës (ndihmës administrativ) për zhvillimin e bujqësisë”, në Njësinë Administrative Trebinjë.

Meqenëse, emërtesa e pozicionit të punës “Punonjës (ndihmës administrativ) për zhvillimin e bujqësisë”, ka krijuar tek punonjësi i sipërpërmendur përshtypjen se mund të jetë një vend pune i cili nuk plotëson karakteristikat e një pozicioni që përfshihet në fushën e shërbimit civil, duke rezultuar në daljen etij nga shërbimi civil, është verifikuar hollësisht përmbajtja dhe natyra e funksionit, duke analizuar kompetencat dhe detyrat konkrete ai që do të kryente, sipas formularit të ri të përshkrimit të punës (miratuar nga Kryetari i Bashkisë Pogradec).

Nga verifikimi konstatohet se punonjësi që do të kryente detyrën “Punonjës (ndihmës administrativ) për zhvillimin e bujqësisë” në Njësinë Administrative Trebinjë, ndërmjet të tjerave, ka në përmbajtje të funksionit të tij: mbështetjen dhe zbatimin e procedurave, rregullave e standardeve të prodhimit bujqësor; sigurimin e cilësisë të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor; certifikimin dhe regjistrimin e varieteteve të bimëve në Katalogun Kombëtar të Bimëve; zbatimin e politikave të mbarështimit pyjor; kujdesin për zhvillimin e qëndrueshëm të fondit kombëtar pyjor; ndjekjen e punës për vjeljen e prodhimeve pyjore duke siguruar vazhdimësinë e tyre; ndjekjen e shkallës së ruajtjes së mjedisit pyjor dhe ripërtëritjes natyrore, etj., kompetenca këto të cilat në bazë të nenit 4, pika “c”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, plotësojnë kushtin kryesor për të qenë nëpunës civil, atë të ushtrimit të autoritetit administrativ, publik, zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative që lidhen me funksionin e tij dhe ofrimin e mbështetjes administrative për zbatimin e tyre, etj.

Në kushtet e mësipërme, arrihet në përfundimin se në nxjerrjen e këtyre akteve, janë respektuar të gjitha rregullat dhe procedura e parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar; Vendimi nr. 171, datë 26.03.2014, i Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil” (kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe rristrukurimit të institucionit”) dhe Udhëzimi nr. 3, datë 14.04.2014, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të rristrukurimit për shkak të mbylljes apo rristrukurimit”, i Departamentit të Administratës Publike.

Konkretisht, në praktikën e kryerjes së këtij veprimi administrativ, rezulton se: **a)** Është ngritur rregullisht, Komisioni i Ristrukturimit (*akti nr. 152, datë 12.10.2015, të njësisë përgjegjëse*); **b)** Është mbajtur relacioni për shqyrtimin e mundësisë të sistemimit të nëpunësit, i cili materializon veprimtarinë e këtij komisioni (*akti nr. 184 prot., datë 30.12.2015, të Komisionit të Ristrukturimit*); **c)** I është paraqitur, njësisë përgjegjëse, propozimi për transferimin e nëpunësit (*akti nr. 394, datë 30.12.2015, të Komisionit të Ristrukturimit*); **d)** Është mbajtur parasysh kushti i parashikuar prej nenit 48, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar, për gjendjen shëndetësore dhe distancën e pozicionit të punës të ofruar nga vendbanimi i nëpunësit civil, e cila nuk është më shumë se 45 km; **e)** Nëpunësi është transferuar në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori, duke respektuar në këtë mënyrë kërkesën e pikës 1, të nenit 50, të ligjit të sipërcituar, po kështu është respektuar përparësia e përcaktuar në pikën 2, të këtij neni; **ë)** Është nxjerrë vendimi përfundimtar nga njësia përgjegjëse, për miratimin e propozimit për transferim, të Komisionit të Ristrukturimit (*akti nr. 26, datë 21.01.2016, të njësisë përgjegjëse*).

Nisur nga gjithë sa më sipër, arrihet në përfundimin se, në nxjerrjen e vendimit nr. 26, datë 21.01.2016, të njësisë të menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Pogradec, për transferimin e përhershëm për shkak rristrukturimi, të nëpunësit \*\*\*\*\* nga pozicioni “Specialist për promocionin e turizmit”, pranë Bashkisë Pogradec, në pozicionin “Punonjës (ndihmës administrativ) për zhvillimin e bujqësisë”, në Njësisë Administrative Trebinjë, pranë Bashkisë Pogradec, janë respektuar rregullat dhe procedurat e parashikuara nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar; kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe rristrukurimit të institucionit”, i Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, i Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” dhe Udhëzimin nr. 3, datë 14.04.2014, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të rristrukurimit për shkak të mbylljes apo rristrukurimit”, të Departamentit të Administratës Publike.

#### **Për këto arsye:**

Bazuar në nenet 14, 15 dhe 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; nenet 115, pika “a”, 116 pika “c” dhe 117, pika 1, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative në R. SH”; nenin 34, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë të aktit administrativ nr. 26, datë 21.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë Pogradec, për transferimin e përhershëm për shkak rristrukurimi, të nëpunësit civil \*\*\*\*\* , nga pozicioni “Specialist për promocionin e

*turizmit*”, pranë Bashkisë Pogradec, në pozicionin “*Punonjës (ndihmës administrativ) për zhvillimin e bujqësisë*”, në Njësisë Administrative Trebinjë, pranë Bashkisë Pogradec.

2. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, të Bashkisë Pogradec, me miratimin e strukturës pasardhëse, të marrë masat e nevojshme për të emërtuar dhe klasifikuar, si këtë pozicion të shërbimit civil “*Punonjës (ndihmës administrativ) për zhvillimin e bujqësisë*”, ashtu dhe pozicionet e tjera të punës, sipas kategorisë, klasës dhe natyrës së pozicionit, duke u bazuar në përshkrimet e tyre të punës, në përputhje me emërtesat dhe klasifikimet e përcaktuara në nenin 19, të ligjit 152/2013 “*Për shërbimin civil*”, i ndryshuar.
3. Të njoftohet për këtë vendim, Njësia e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Pogradec dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**